Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0759

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si Kryetare, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "B&D Engineering" Sh.P.K. kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 12.09.2023 të Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. për anulimin eaktivitetit të prokurimit me titull "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese në bllokun A3" me nr. të prokurimit KEK-22-13147-5-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë19.12.2023 merr këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "B&D Engineering" Sh.P.K. me nr. 2023/0759 e datës 04.10.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 12.09.2023 të Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese në bllokun A3" me nr. të prokurimit KEK-22-13147-5-2-1.

2.AnulohetNjoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 12.09.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

3.Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

4.Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së asnkesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 01.12.2022 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese në bllokun A3" me numër të prokurimit KEK-22-13147-5-2-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 400,000.00€. Kriteri i dhënies ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Me datë 12.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit.

Me datë 16.09.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 25.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Operatori Ekonomik Ankues me datë 04.10.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0759.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Pretendimet kryesore (themelore) të operatorit ekonomik ankues kanë të bëjnë me faktin se ankuesi nuk pajtohet me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të

prokurimit. Konkretisht ankuesi pretendon se arsyet për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk janë në përputhje me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 paragrafët 43.5 dhe 43.7 të RRPP.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 62 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që të kthehet lënda në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP me datë 06.10.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 10.10.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit me rekomandimet si në vijim: "*ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim*".

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "*Bazuar në argumentet dhe sqarimet e paraqitura nga OE ankues, dhe duke marrë parasysh që OE ankues ka mbrojtur interesat e tyre të ligjshme si kompania e vetme e autorizuar nga prodhuesi Flowserve si dhe bazuar ne raportin e komisionit vleresues dhe dokumentacionit në eprokurimi, eksperti shqyrtues rekomandon disa hapa të rëndësishëm. Eksperti shqyrtues rekomandon që paneli shqyrtues të aprovon ankesën e OE ankues, duke e konsideruar të bazuar dhe të rëndësishme për procedurën e prokurimit publik. Panelit shqyrtues i rekomandohet që njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të anulohet, pasi që ky veprim duket se është i paligjshëm ose i papërshtatshëm në këtë rast duke mos plotesuar kriteret për një procedurë të përfunduar. Panelit shqyrtues i rekomandohet po ashtu që lënda të kthehet në rivlerësim ose të vazhdohet me procedurën e prokurimit, duke u bazuar në raportin e komisionit vlerësues. Ky veprim mund të sigurojë një proces të drejtë dhe transparent për të gjithë ofruesit, përfshirë OE ankues".*Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43 paragrafët 43.5 dhe 43.7 të RRPP.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues dhe njoftimit mbi vendimin B58 është gjetur se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit është formuluar si në vijim: "*Në këtë aktivitet të prokurimit dy OE kanë autorizim nga i njëjti OE-Flowserve dhe kanë ofertuar Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë, Sarmart LT s.r.o. me çmim 299,999.99 euro dhe B&D Engineering Sh.P.K., Novamat Sh.P.K. me çmim të ofertës 344,560.00 euro. Gjatë fazës së vlerësimit kemi pranuar emailin me datë 23.03.2023 dhe 24.03.2023 nga anëtari i GOE Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë & Sarmat LT s.r.o. i njëjti është tërhequr nga aktiviteti i prokurimit. Nga komunikimet e pranuara vërehet qartë ndërhyrja e anëtarit të konzorciumit Novamat që të mos i mundësohet dhënia e kontratës GOE Klaus Union CZ AS Dega në Kosovë & Sarmat LT s.r.o. Bazuar në komunikimet e pranuara ZPP nuk është aprovuar rekomandimi i komisionit të rivlerësimit për shkak të ndikimit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në këtë aktivitet të prokurimit nga GOE B&D Engineering Sh.P.K. & Novamat ku qëllimi i këtij OE ka qenë që të pranohet oferta e tij*".

Përmes nenit 62 paragrafit 1 të LPP është përcaktuar se "*Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:* ***1.*** *një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit* ***2.*** *të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo* ***3.*** *para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontaktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit*".

Tutje përmes nenit 43 paragrafit 43.5 të RRPP është përcaktuar se "*Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:* ***a.*** *asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;* ***b.*** *asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;* ***c.*** *numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);* ***d.*** *nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;* ***e.*** *numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;* ***f.*** *nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;* ***g.*** *asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;* ***h.*** *nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;* ***i.*** *një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;* ***j.*** *nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose* ***k.*** *nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP*".

Në këtë rast Paneli Shqyrtues ka gjetur se arsyet e përcaktuara në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk përkojnë me asnjë nga rrethanat e përcaktuara përmes nenit 62 paragrafit 1 të LPP apo përmes nenit 43 paragrafëve 43.5 dhe 43.7 të RRPP. Rrjedhimisht është gjetur se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim të plotë pikërisht me këto dispozita ligjore. Prandaj Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues ku thuhet se "Panelit shqyrtues i rekomandohet që njoftimi për anulimin e aktivitetit të

prokurimit të anulohet, pasi që ky veprim duket se është i paligjshëm ose i papërshtatshëm në këtë rast duke mos plotesuar kriteret për një procedurë të përfunduar. Panelit shqyrtues i rekomandohet po ashtu që lënda të kthehet në rivlerësim ose të vazhdohet me procedurën e prokurimit, duke u bazuar në raportin e komisionit vlerësues". Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht pretendime të bazuara. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe faktin se komisioni vlerësues ka gjetur se oferta e operatorit ekonomik ankues është oferta më e lirë e përgjegjshme në përputhje me kriterin për dhënie të përcaktuar përmes dosjes së tenderit. Në anën tjetër zyrtari përgjegjës i prokurimit me rastin e refuzimit të rekomandimit nga komisioni vlerësues nuk ka kundërshtuar asnjëherë me prova dhe argumente të bazuara këto të gjetura të komisionit vlerësues. Sa i përket pretendimeve të ZPP për ushtrim të ndikimit nga ankuesi te një tenderues tjetër, Paneli Shqyrtues konsideron se për këtë çështje ekzistojnë organe tjera kompetente të cilat duhet konfirmojnë një pretendim të tillë. Në të kundërtën pretendimi për ushtrim të ndikimit nuk përbën arsye për anulim të aktivitetit të prokurimit përderisa ky pretendim nuk është konfirmuar nga organeve kompetente ose në komunikim me prodhuesin (të paktën në nivelin e dyshimit të bazuar), andaj në rethana të tilla paneli vlerëson se mbetet në diskrecion të AK gjatë procedurës së rivlerësimit ti ndërmerr veprimet nëse eventulisht sipas tij/saj konsiderohen të nevojshme per të, si inciuese e këtij aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. të datës 12.09.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Demontimi, modernizimi dhe instalimi i pompës furnizuese në bllokun A3" me nr. të prokurimit KEK-22-13147-5-2-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **B & D ENGINEERING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: